



## **NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJEVE TË VENDOSURA NË PROCESIN E LIKUIDIMIT**

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjeve/Aseteve sipas listës së mëposhtme (në shtojcë) ka filluar me datë 26 shkurt 2020 dhe 3 mars 2020 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 23 dhjetor 2019 dhe 29 janar 2020.

Më datën 15 Mars 2020 Qeveria e Republikës së Kosovës e ka nxjerrë vendimin nr. 01/11 me të cilin është shpallur *“Gjendja Emergjente për Shëndetin Publik”* për shkak të pandemisë globale (SARS-CoV-2). Duke pasur parasysh rrethanat e krijuara në lidhje me rrezikimin e shëndetit publik dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me 30 prill 2020 ka vendosur që të caktohet një afat i ri shtesë prej 45 (dyzetepesë) ditësh për parashtrimin e Dëshmime të Kërkesës dhe Dëshmime të Interesit lidhur Ndërmarrjet/Asetet e vendosura në likuidim sipas listës së mëposhtme (në shtojcë).

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj këtyre Ndërmarrjeve apo Aseteve të Ndërmarrjeve (në shtojcë) duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Personat që kanë parashtruar Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit përgjatë afatit të rregullt të pranimit në lidhje me Ndërmarrjet/Asetet sipas listës së mëposhtme të vendosura në likuidim, nuk është e nevojshme të ri-parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit.

**Në rast se nuk keni parashtruar Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit përgjatë afatit të rregullt të pranimit, ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj.**

**Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të cekur më poshtë, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje së kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 8 qershor 2020 dhe përfundon me datë 23 korrik 2020 në orën 16:00.**

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00. Lidhur me adresat e Zyrave Rajonale të AKP-së, emrave alternativë dhe informatave të tjera të Ndërmarrjeve/Aseteve të listuara më poshtë, i referoheni njoftimeve në faqen e internetit të AKP-së, duke klikuar në njoftimet individuale tek shtegu përkatës më poshtë:

Shtegu në gjuhën shqipe: <http://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,57>

Shtegu në gjuhën serbe: <http://www.pak-ks.org/page.aspx?id=3,57>

Shtegu në gjuhën angleze: <http://www.pak-ks.org/page.aspx?id=2,57>

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni “Formularët-Udhëzime për plotësim”. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.

## SHTOJCË:

### LISTA E NDERMARRJEVE TË VENDOSURA NË PROCESIN E LIKUIDIMIT

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Komuna
1	MIT106	Fabrika e Tullave dhe Tjegullave	Zveçan
2	MIT107	Ndermarrja Ndertimore Industriale Berilje	Mitrovica e Veriut
3	MIT126	Shoqata e Kooperativave Bujqesore	Zveçan
4	MIT151	Kras Zagreb	Mitrovica e Veriut
5	MIT152	Bagat Beograd	Mitrovica e Veriut
6	MIT153	Ibar Invest Zubin Potok	Zubin Potok
7	MIT156	Planika Kranj	Mitrovica e Veriut
8	MIT157	7 Juli	Mitrovica e Veriut
9	MIT162	Ibar	Mitrovica e Veriut
10	MIT164	Ndermarrja Ndertimore Ndertimtari	Glllogoc
11	PEJ166	Pushimorja e Femive	Deçan
12	PRN170	JUGOPETROL	Prishtinë
13	PRN180	DUNAV OSIGURANJE	Prishtinë
14	PRN183	KOMPANIA E SIGURIMEVE KOSOVA	Prishtinë
15	PRN184	MONTING ENERGETIKA	Prishtinë
16	PRN185	ORGANIZATA E PËRBËRË RILINDJA	Prishtinë
17	PRN186	EMINENT	Prishtinë
18	PRN190	Centrotexil-Import-Export	Prishtinë

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Komuna
19	PRN191	NISPROMET	Prishtinë
20	PRZ079	Varteks Varazhdin	Prizren
21	PRZ086	KB Bujku Drenovc Rahovec	Rahovec
22	PRZ087	KB Zocishta Zoqishtë Rahovec	Rahovec
23	PRZ090	KB Hoqa e Qytetit	Prizren
24	PRZ091	KB Opterusha	Rahovec
25	PRZ092	KB Krusha e Madhe	Rahovec
26	PRZ093	KB Mamusha	Mamushë
27	PRZ094	KB Studencani	Suharekë
28	PRZ007	Sharrprodhimi	Dragash
29	MIT056	Vijak/Gradec	Zubin Potok
30	MIT119	Ndermarrja per menaxhimin e banesave	Mitrovica e Jugut
31	MIT165	Iskra	Mitrovica e Veriut
32	PEJ205	Agromehanzacia	Pejë
33	PRN192	KB Slloga	Prishtinë
34	PRN194	Solid	Prishtinë
35	PRN195	Vojvodanska Banka a.d.	Prishtinë
36	PRN196	OTHPB Transhped Kontinentalna Shpedicija - Beograd	Prishtinë